

LIGJ
Nr.9957, datë 17.7.2008
PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8488, DATË 13.5.1999 “PËR MBROJTJEN E
TOPOGRAFISË SË QARQEVE TË INTEGRUARA”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Në ligjin nr.8488, datë 13.5.1999 “Për mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Kudo në ligj, emërtimi “Drejtoria e Patentave dhe Markave” zëvendësohet me emërtimin “Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave”.

Neni 2

Në nenin 6, fjalët “pranë bordit të apelit” zëvendësohen me fjalët “pranë bordit të apelimit”.

Neni 3

Neni 18 ndryshohet si më poshtë:

Neni 18

Dispozitat e përfaqësimit të të huajve, pavlefshmëria e aplikimeve të publikuara, pranimi i aplikimit, data e hyrjes dhe ndryshimet në regjistër, pavlefshmëria e të drejtave, afatet kohore të shkeljes së të drejtave, masat kundër shkeljeve të të drejtave, transferimi i të drejtave, licencat, si dhe çdo rregull tjetër procedural, i parashikuar në ligjin nr.9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”, rregullohen dhe janë të vlefshme edhe për këtë ligj.”

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 3 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5835, datë 29.7.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi